



**BASHKIA  
TIRANË**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

**Nr.131 , datë 30.09.2020**

**“PËR  
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.157, DATË 26.12.2019, TË  
KËSHILLIT BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMESËM 2020-2022 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS  
PËR VITIN 2020”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nën pikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c” nenit 41, pika 1, neni 54, shkronja “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, nenit 43 dhe nenit 44, të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimit nr. 650, datë 13.8.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, në Bashkitë Tiranë dhe Kurbin”, Vendimit nr. 732, datë 16.09.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të banesave individuale, të njësive të banimit në ndërtesa(pallat) si dhe mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në Bashkitë Krujë, Shijak, Durrës dhe Tiranë”, Udhëzimit plotësues nr. 2 datë 20.01.2020, të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

Në vendimin nr.157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në nën pikën 1 të pikës 1, të miratojë një shtesë në planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020 sipas pasqyrës nr. 1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Në zbatim të pikës nr.1, të miratojë detajimin e shtesës si dhe rishpërndarjen e fondeve të shpenzimeve korrente dhe kapitale ndërmjet programeve buxhetore sipas pasqyrës nr.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë rishpërndarjen dhe detajimin e shtesës së fondeve të rindërtimit akorduar në formën e transfertës së pakushtëzuar për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore(DS4 dhe DS5) aktekspertiza të thelluara si dhe financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të banesave individuale, të njësive të banimit në ndërtesa(pallat) në programin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Mbrojtjes Civile sipas pasqyrës nr. 3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Të miratojë shtesën e fondeve në programin e Arsimit Universitar sipas pasqyrës nr. 4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

5. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve të akorduara nga Qeverisja Qendrore në programin e Ujitjes dhe Kullimit sipas pasqyrës nr. 5, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

6. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA dhe Emergjencave Civile, Klubi Sportiv “Tirana”, Qendra Komunitare “Të Qëndrojmë së Bashku”, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R**

**TONI GOGU**